

Syllabusi për lëndën: Ekzekutimi i dënimeve alternative

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Ekzekutimi i dënimeve alternative
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri II
Numri i orëve në javë:	2 +1
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	E hënë, ora: 15.30-17.30, Salla D2.
Viti akademik	2017/2018
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc.Rexhep Gashi, profesor i rregullt
Detajet kontaktuese:	Email: rexhep.gashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Ekzekutimi i dënimeve alternative është discipline e re shkencore e cila në fokus të interesimit të saj ka çështjet themelore që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimeve alternative dhe riintegrimin shoqëror të personave të dënuar në shoqërinë bashkëkohore. Në kuadër të kësaj discipline mësimore trajtohet njësitë e zgjedhura mësimore siç janë: kuptimi dhe karakteristikat e dënimeve alternative sipas dokumentave dhe normave ndërkombëtare dhe të disa legjislacioneve të vendeve bashkëkohore; llojet e dënimeve dhe masave alternative dhe mënyrat e ekzekutimit të tyre; organizimi i ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative; roli dhe rëndësia e Shërbimit Sprovues të Kosovës në ekzekutimin e dënimeve alternative; trajtimi shkencor i ekzekutimit të dënimeve alternative veç e veç etj. Gjatë shtjellimit të këtyre njësive mësimore studentët do të kenë mundësi të kenë qasje në burime të shumta, akte juridike ndërkombëtare dhe nacionale të fushës së provimit, si dhe në materiale të tjera shtesë të kësaj fushe të studimit.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kjo lëndë mësimore ka për qëllim që të ndihmoj studentët e programit master që të thellojnë njohuritë e tyre lidhur me dënimet alternative dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre. Përmes qasjes së tyre në burime të shumta juridike të kësaj fushe, studentët do të</p>

	<p>pajisen me njohuri të avancuara shkencore lidhur me karakteristikat e ekzekutimit të këtyre dënimeve në shoqërinë bashkëkohore, qëllimin e ekzekutimit të tyre; trajtimin e pozitës së personave të dënuar gjatë ekzekutimit të këtyre dënimeve, me vështrim të posaçëm në praktikën e Republikës së Kosovës. Po ashtu, ata do të jenë në gjendje që t'i krahasojnë rezultatet e arritura shkencore të fushës së ekzekutimit të dënimeve alternative me vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë dhe ti zbatojnë ato rezultate me sukses në fushat e studimit dhe punës së tyre.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të studimit të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të jetë i kompletuar me njohuri të avancuara shkencore lidhur me qasjet e ndryshme teorike dhe praktike mbi ekzekutimin e dënimeve alternative. 2. Të përcjellë dhe krahasojë rezultatet e arritura shkencore në fushën e Ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të përdorë këto rezultate në procesin e riedukimit të personave të dënuar. 3. Të jetë sa më tepër i familjarizuar me qëndrimet dhe rezultatet shkencore të autorëve të njohur ndërkombëtar të kësaj fushe të studimit, përfshirë edhe aftësimin që të ketë qasje kritike ndaj pikëpamjeve të autorëve të tjerë lidhur me problemet që kanë të bëjnë me ekzekutimin e këtyre dënimeve dhe riintegrimin e personave të dënuar. 4. Të zbatojë njohuritë dhe rezultatet e shkencës së Ekzekutimit të dënimeve alternative në praktikën e riedukimit dhe riintegrimin të suksesshëm të personave të dënuar në ambientin shoqëror.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënërit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min.	15	1.5
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfieme,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	4	5	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	1	2	2
Totali			89.5 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Metodologjia e mësimdhënies do të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ligjërata interaktive: Në pjesën më të madhe të kohës do të organizohen ligjërata interaktive që d.m.th. se përveç ligjërimit nga ana e mësimdhënësit, kyçen edhe studentët, qoftë duke pyetur apo edhe duke diskutuar dhe këmbyer mendimet e tyre lidhur me çështjet tematike që janë objekt i ligjërates. - Punimet seminarike: Studentët do të kenë mundësi të përcaktohen për ndonjë temë apo punim seminarik, ku para fillimit të punës së tyre, atyre u ofrohen udhëzimet elementare lidhur me hartimin e punimeve të tilla, dhe pas përfundimit të tyre ata kanë mundësi të prezantimit para studentëve të tjerë të rezultateve të punimeve të këtyre, ku edhe do të zhvillohen debate lidhur me temat e trajtuara. - Ndarja në grupe të vogla të studentëve: Do të bëhet përpjekje në aplikimin e punës grupore me studentë, ku ata ndahen në grupe të vogla me qëllim të debatimit dhe kyçje së këtyre grupeve në 		

trajtimin e temave të ndryshme që do të jenë objekt i ligjërimit.

- Zbatimi i metodave bashkëkohore të ligjërimit:
Gjatë punës me studentë do të përdoren metoda dhe teknika të tjera dhe bashkëkohore të ligjërimit të cilat do të jenë në funksion të shpjegimit të problemeve themelore ekzekutimit të dënimeve alternative në mënyrë që studentët të kenë mundësi të kyçen pa probleme në nxënien dhe përvetësimin e materies që është objekt trajtimi.

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i studentëve bazohet në format e fitimit të pikëve të shprehura në % si vijon:

- Vlerësimi i parë intermediar.....20%
- Vlerësimi i dytë intermediar.....15%
- Punimi seminarik.....10%
- Vijimi i rregullt dhe pjesëmarrja aktive.....5%
- Provimi final.....50%
- Totali.....100%

Përshkrimi i sistemit të notimit:

Nota	ECTS nota	Pike	Përkufizimi
10	A	91–100 %	SHKËLQYESHËM - njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore
9	B	81 – 90 %	SHUMË MIRË – mbi mesatare standarde,por me disa gabime
8	C	71 – 80 %	MIRË – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen
7	D	61 – 70 %	KËNAQSHËM – mire, por me mjaft gabime
6	E	51 – 60 %	MJAFTON – rezultatet plotësojnë kriteret minimale
5*	FX	40 – 50 %	DOBËT – kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kreditë
5	F	00 - 39 %	DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kredi

Literatura

Literatura bazë:

Dr.Rexhep Gashi, *Ekzekutimi i dënimeve alternative*, Prishtinë, 2013.

Literatura shtesë:

Rexhep Gashi, Metije Ademi, *Probation in Europe – Kosovo*, botuar nga Confederation of European Probation (CEP), fq.40, online:
http://www.cep-probation.org/default.asp?page_id=157&map_id=152

	<p>Craig Russel, <i>Alternatives to Prison: Rehabilitation and Other Program</i>, Mason Crest Publishers, 2006.</p> <p>Dean J.Champion, <i>Probation, Parole and Community Corrections</i> (6 edition), Prentice Hall, 2007.</p> <p>Anton M.van Kalmthout, Jack T.M.Derks (Editors), <i>Probation and Probation Services (A European Perspective)</i>, The Netherlands, 2000.</p> <p>Gary W. Lavigna, <i>Alternatives to punishment</i>, Ardent Media Inc., 2007.</p> <p>Joan Petersilia (editor), <i>Community Corrections: Probation, Parole, and Intermediate Sanctions</i> (Edition 1), Oxford University Press, USA, 1997.</p> <p>Norval Morris, Michael Tonry, <i>Between Prison and Probation (Intermediate Punishments in a Rational Sentencing System)</i>, Oxford University Press, 1990.</p> <p>Curt R. Blakely, <i>Prisons, Penology and Penal Reform: An Introduction to Institutional Specialization</i>, Peter Lang Publishing, 2007.</p> <p>Susan Easton, Christine Piper, <i>Sentencing and Punishment</i>, Oxford University Press, 2005.</p> <p>David Scott, <i>Penology</i>, Saga Publications, 2008.</p> <p>Ragip Halili, <i>Penologjia</i>, Prishtinë, 2014.</p> <p>Ismet Salihu, <i>E drejta penale, pjesa e përgjithshme</i>, Prishtinë, 2015.</p> <p><i>Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale</i>, Prishtinë, 2013.</p>
--	---

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i shkencës së Ekzekutimit të dënimeve alternative - Lënda e studimet të Ekzekutimit të dënimeve alternative - Metodatat e studimit të Ekzekutimit të dënimeve alternative

Java e dytë:	- Kuptimi dhe karakteristikat e dënimeve alternative - Dënimet alternative sipas dokumentave dhe normave ndërkombëtare.
Java e tretë:	- Llojet e dënimeve alternative sipas legjislacionit penal të Republikës së Kosovës; -Parimet e përgjithshme dhe qëllimi i ekzekutimit të dënimeve alternative.
Java e katërt:	- Organizimi i ekzekutimit të dënimeve alternative - Organet dhe shërbimet për ekzekutimin e dënimeve alternative.
Java e pestë:	- Organizimi i ekzekutimit të dënimeve alternative sipas legjislacionit dhe praktikës së Kosovës; -Shërbimi Sprovues i Kosovës dhe struktura organizative e tij; -Historiku i shkurtër i Shërbimit Sprovues të Kosovës; -Struktura organizative e Shërbimit Sprovues të Kosovës.
Java e gjashtë:	-Parimet e veprimtarisë së Shërbimit Sprovues të Kosovës; -Shërbimi i provës në Shqipëri
Java e shtatë:	-Testi i parë intermediar
Java e tetë:	-Ekzekutimi i dënimit me kusht
Java e nëntë:	-Ekzekutimi i dënimit me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues
Java e dhjetë:	-Ekzekutimi i dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues
Java e njëmbëdhjetë:	-Ekzekutimi i dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme
Java e dymbëdhjetë:	-Ekzekutimi i dënimit në gjysmëliri
Java e trembëdhjetë:	-Ekzekutimi i alternativave të dënimit me burgim në Shqipëri
Java e katërmëdhjetë:	-Testi i dytë intermediar
Java e pesëmbëdhjetë:	Përsëritja e lëndës dhe mbrojtja e punimeve seminarike.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studentët gjatë procesit të mësimit, provimeve, por edhe gjatë pranisë së tyre në fakultet duhet pasur kujdes që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të respektojnë mësimdhënësin dhe personelin joakademik të universitetit; - mos të pengojnë procesin mësimor; - të dëgjojnë me kujdes si mësimdhënësit ashtu edhe kolegët e tyre; - mos të përdorin ushqim, pije, goma përtpëse në sallë të

mësimi;

- mos të përdorin telefonat mobil në sallë të mësimi;
- të hyjnë me kohë në sallë të mësimi;
- mos të kopjojnë gjatë provimit dhe testeve të tjera.